



Pranuar / Doretuar Prilbena / Prilbato Received / Delivery	01. 11 2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednitca Org / Unit	SKM&H/C 6815/2023	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicitka Quantity
			1/2



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr.1189/2023**

**Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërja nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare; Jeton Koca dhe Eshref Shabani, anëtarë; me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas ankesës me numër A.nr.1189/2023 të datës 20.09.2023, të parashtruar nga ankuesja [redacted], në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5; të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 01.11.2023, njëzëri mori këtë:

**V E N D I M**

**Përfundon procedimi administrativ** i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.1189/2023, të datës 20.09.2023, të parashtruar nga ankuesja [redacted]

**A r s y e t i m**


Ankuesja [redacted] më datë 20.09.202, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil, kundër Njoftimit të datës 13.09.2023, të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, lidhur me refuzimin e aplikacionit për pozitën “Drejtor i Përgjithshëm” në Institutin e Kosovës për Administratë Publike, i shpallur sipas Konkursit të hapur me numër të referencës RN00012129, ndërsa, më datë 31.10.2023, e njëjta, përmes shkresës me numër protokollit 6793//2023, për arsye personale është tërhequr nga ankesa A.nr.1189/2023 e datës 20.09.2023.

Kolegji i Këshillit duke marr për bazë kërkesën e datës 31.10.2023 të ankueses, për tërheqje nga ankesa, konstatoi plotësimin e kushtit ligjor për përfundimin e procedimit administrativ, siç parashihet me dispozitat e nenit 103 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë”, dhe si rrjedhojë në mbështetje të nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi për

përfundimin e procedimit administrative të filluar sipas ankesës me numër A.nr.1189/2023 të datës 20.09.2023, si në dispozitiv të këtij vendimi.


**Këshillë juridike:** Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit është i paligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
*Lënda me numër A.nr.1189/2023.*

Ardita Perçuku-Shyti  
  
Procesmbajtëse



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit 
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

